

**Letër e hapur
Kryetarit të Komunës së Lipjanit z. Shukri Buja**

I nderuari z. Buja,

Fillimisht, dëshirojmë të jua urojmë mandatin e fituar, duke shpresuar që katër vitet e ardhshme do t'i shfrytëzoni për prosperitetin e komunës suaj dhe përmbushjen e premtimeve të dhëna, në bazë të të cilave qytetarët ju kanë dhënë besimin.

Instituti për Studime të Avancuara GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Huluntuuese (BIRN) kanë monitoruar aktivitetet dhe premtimet e juaja, të dhëna gjatë fushatës zgjedhore në periudhën 15 tetor – 14 nëntor 2009 dhe 7 – 12 dhjetor 2009. Si rezultat i monitorimit tonë të bërë në mediat e shkruara dhe elektronike, si dhe në dy debatet e juaja të mbajtura në "Jeta në Kosovë", ju keni premtuar:

- Investime në infrastrukturë rrugore, kanalizim, ujësjellës dhe në fusha të tjera;
- Punësimin e rasteve sociale;
- Sistemimin e veteranëve të luftës dhe kategorive të dala nga lufta;
- Përkrahjen e vazhdueshme të familjeve të dëshmoreve dhe martirëve të luftës;
- Krijimin e hapësirave ku rinia do të zhvillojë aktivitetet sportive dhe kulturore;
- Renovimin e shtëpisë së kulturës si dhe funksionimin e sferave të kulturës, si kinematografisë, artit skenik dhe të gjitha ato fusha që i kërkon rinia lipjanase;
- Digjitalizimin e bibliotekës së qytetit;
- Administratë digjitale;
- Renovimin e stadiumit të qytetit;
- Ngrohjen qendrore me energji alternative për qytetin e Lipjanit (me metan, drithëra dhe sillaxhë ku do të përfitojnë edhe bujqit, projekt ky me koncesion dhe investim i një firme nga Lozana, projekt i cili do të përfundoj brenda tre vjeçarit të qeverisjes);
- Për fshatin Smallushë: rregullimin e gjithë infrastrukturës; ndërtimin e një shkolle të re dhe një fushe të futbollit;
- Për banorët e Gadimes: ndërtimin e një objekti të ri shkollor me përmasa më të mëdha dhe me ambiente më moderne; asfaltimin e të gjitha rrugëve të brendshme;
- Arsim cilësor duke ndërtuar infrastrukturës të shkollës me pedagog, mjek dhe psikolog dhe me ngrohje qendrore;
- Krijimin e 5 mijë vendeve të reja të punës;
- Shëtitore dhe parqe;
- Zhvillimin ekonomik sidomos në fushën e bujqësisë;
- Ndërtimin e dhjetë fabrikave;
- Përfundimin e rrugëve të paasfaltuara, kanalizimet dhe ujësjellësit për fshatrat e Komunës së Lipjanit;
- Ndërtimin e dy qendrave atë të agrobiznesit dhe qendrën në tokën jo punuese industriale në Kërqeve të Ribarit të Madh;
- Zhvillimin e turizmit;
- Përpunimin e plehrave të pulave në mënyrë që të largohet era nga ferma e pulave;
- Sinjalizimi horizontal i komunikacionit.



Për fund, ju bëjmë me dije se Instituti GAP dhe BIRN, në fund të çdo viti kalendarik, do të dalin me raporte vlerësuese rreth përmbushjes së premtimeve të dhëna nga kryetarët e komunave.

Ju urojmë qeverisje të suksesshme dhe shpresojmë në bashkëpunimin tuaj edhe në të ardhmen.

Sinqerisht,

Instituti për Studime të Avancuara GAP
Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN)